

SHOQËRI TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE
KUFIZUAR

AKT – THEMELIMI

I SHOQËRISË

“CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS” sh.p.k.

DURRËS – ALBANIA

Durres, me 31. 10. 2019





SHOQERI TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

DHE

ORTAK TE VETEM
“CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS” sh.p.k.

DURRES – ALBANIA

AKT THEMELIMI

Ne DURRES sot me daten **31 Tetor 2019** (dymije e nentembehjete), ditën e **Enjte**, shtetasja e identifikuar si me poshte:

1. Zj. NEVJANA KACMOLI, atesia HAMZA, amesia VJOLLCA, e datelindjes 11. 02. 1987, shtetase shqiptare, lindur ne DURRES dhe banuese ne L.1 Rr. “Anastas Durrsaku”, Durres, e pranishme ne kete akt nen cilesine e perfaqesuesit te ortakut te vetem nepermjet prokures se posacme bashkengjitur aktit ne fjale dhe bazuar ne:

* Prokuren e posacme leshuar nga ortakut i vetem, shoqeria Crystal System Group Ltd,

* Ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

* Ne Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare »

* Ne Ligjin Nr. 9723 date 03.05.2007 « Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit”.

* Ne Ligjin Nr. 7764 date 02.11.1993 « Per Investimet e huaja », dhe ne te

Drejten nderkombetare Publike dhe Konventat nderkombetare te gjithe pranuar te Komunitetit European me anen e ketij Akti Themelimi, shpreh vullnetin e ortakut te vetem dhe prokureleshuesit Crystal System Group Ltd te krijoj Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar dhe Ortak te Vetem « CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS » Sh.p.k si me poshte:

NENI 1

Personi i siperpermendur, me vullnetin e saj te lire dhe ne liri te plote themelon shoqerine me pergjegjesi te kufizuar dhe ortak te vetem te emeruar “CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS” shpk. Ky emerim do te jete i stampuar edhe ne vulen e shoqerise.

Ortakut i vetem i shoqerise me 100% te kuotave dhe vlere nominale prej 100.000 (njeqind mije) lekesh eshte shoqeria qipriote “CRYSTAL SYSTEM GROUP” Ltd me seli ne Agias Fylaxeos & Zenonos Rossidi 2, Limasol 3082, Qipro, regjistruar prane regjistrimit tregtar te Ministrise se Energjise, Tregtise dhe Industrise, Qipro me numer kompanie HE92271.

Mbeshtetur nga sa me lart u shpreh, kjo shoqeri do te jete titullare e nje kuote ne vleren nominale 100.000 leke.





NENI 2

Shoqëria "CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS" sh.p.k me regjistrimin e saj prane organeve kompetente gezon statusin e personit juridik. Aktiviteti i saj do te zhvillohet sipas pikave te paraqitura ne kete akt themelimi, statutit te saj dhe ligjeve ne fuqi. Selia e saj eshte ne Durres, Lagja 1, Rruga "Nako Spiro", Prane Viles se mbretit Zog. Statuti i shoqërise i bashkengjitet ketij akti themelimi dhe eshte pjese integrale e tij.

NENI 3

Shoqëria shtrin aktivitetin e saj tregetar ne te gjithë juridiksionin territorial te Republikës Shqiperise si dhe jashte shtetit.

Me Vendim unanim te Ortakut mund te krijohen ose anulohen (ne rast se jane celur) Seli, Filiale, Agjensi dhe Perfaqesi si ne qytete te tjera te Shqiperise.

NENI 4

Shoqëria "CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS" SH.P.K ka si objekt të saj:

- Sherbime konsulence, trajnimi, ndihmese dhe mbeshtetese per implementimin e teknologjive dhe procedurave te metodologjive BIM (BUILDING INFORMATION MODELING) te cilat u drejtohen profesionisteve, ndermarrjeve, shoqërive te inxhinierise dhe zyrave teknike;
- Krijimin, zhvillimin dhe drejtimin e modeleve BIM (BUILDING INFORMATION MODELING);
- Digitalizimin e informacioneve te lidhura me objektet dhe proceset ne faze zhvillimi, projektimi, ndertimi dhe mirembajtje te nje aseti;
- Aktivitete ne fushen WEB per shkencat dhe BIM (BUILDING INFORMATION MODELING);
- Koordinimin e njesive kerkimore dhe bashkepunimin ne kerkimet per universitetin, insitutet publike dhe private si dhe ndermarrjet e cdo lloji apo permase;
- Aktivitete dhe sherbime te lidhura me zbulimet shkencore dhe teknologjike;
- Mesimdhënenien ne cdo nivel te formimit shkollor dhe universitar;
- Organizim eventesh per perhapjen e njohurive ne fushen dixhitale dhe shkencore;
- Projektimin dhe zhvillimin e projekteve te ndertimit ne pergjithesi si nepermjet BIM dhe CAD dhe gjithashtu te gjitha metodologjite e fushes si per llogari te vet dhe per te trete, si ne ambjetin kombetar dhe nderkombetar;
- Ndertimin per llogari te vet dhe/ose te te treteve, rikostruksionin dhe mirembajtjen e ndertesave te banimit civil, industriale ose te cdo lloji tjeter, te rrugeve, hekurudhave dhe strukturave te lidhura me to;
- Kryerjen e punimeve publike, punimeve per mbrojtjen apo sistemime hidrike te terrenit, ujesjellesve e kanalizimeve, punime ne fushen detare, apo punime speciale per themele apo konsolidimin e terrenit (tokes);
- Realizimin e punimeve dhe impianteve ne fushen e mbrojtjes se mjedisit, monumenteve apo ekologjike;

- 
- Aktivitetin e shit-blerjes-dhenies me qera te pasurive te patundshme ne pergjithesi;
 - Kryerjen dhe ofrimin, ne perputhje dhe respekt te ligjeve ne fuqi, te sherbimeve teknike dhe administrative per llogari te te treteve;
 - Kerkim-studimin dhe eksperimentimin ne sektorin e ndertimit rezidencial;
 - Shoqëria mund të ushtrojë të gjitha aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe financiare, operimin me pasuri të tundshme dhe të patundshme, që nga organet administratuese do të konsiderohen si aktivitete operative, shtesë, të lidhura, të domosdoshme apo të dobishme për realizimin e aktivitetit që përbëjnë objektin social të shoqërisë, të kërkojë interesa apo të ndërmarrë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera që kanë si objekt aktivitete analoge, të përafërta, të lidhura me të sajat, si në menyrë direkte ashtu edhe indirekte, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë shtetit, e gjithashtu të japë garanci dhe të ofrojë dorëzani në favor të të tretëve, edhe pa pagesë, e gjitha kjo për sa kohë këto aktivitete të mos kryhen në ngarkim të publikut dhe masa e ushtrimit të tyre të mos jetë mbizotëruesë në raport me ato aktivitete që përbëjnë qëllimin social.

NENI 5

Kapitali Themeltar i kesaj shoqerie eshte ne likuiditet, i formuar dhe nenshkruar nga ortaku vetem, **shoqeria "CRYSTAL SYSTEM GROUP" Ltd**, ne shumen **100.000 (njeqind mije) leke**, qe zene 100% te Kapitalit themeltar.

Kapitali ndahet ne kuota, gjithsej ne 1 kuota me vlere nominale **1 Kuote/100.000 lek** dhe 1 kuote eshte e barabarte me 1 vote me te drejte venditore.

NENI 6

Kapitali nuk mund te jete kurre i perfaqesuar me letra me vlere dhe derdhja e Kapitalit themeltar te Shoqerise, nuk do te behet para kerkeses se drejtuar Qendres Kombetare te Biznesit per njohjen dhe rregjistrimin e saj si Person Juridik. Kjo vlere do te derdhet ne nje kohe te dyte kur ortaku do ta cilesoje te arsyeshme.

NENI 7

Kohezgjatja e ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise eshte **PA AFAT**, duke filluar ky afat nga dita e Rregjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit, per njohjen dhe rregjistrimin e Shoqerise si Person Juridik.

Me Vendim te Ortakut, kohezgjatje ushtrimit te aktivitetit te Shoqerise mund te ndryshoje dhe ky Vendim dergohet menjehere per depozitim QKB-se, kompetente per te bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare.





NENI 8

Shoqeria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare ne perputhje te plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi, Konventat nderkombetare te gjithepranuara si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit te saj.

NENI 9

Ne mbeshtetje te neni 95 te ligjit 9901 date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i Vetem.

Administrator i kesaj shoqerie do te emerohet per nje periudhe 5 vjecare e cila shtrihet nga 30/10/2019 deri me 29/10/2026, Znj. Nevjana Kacmoli te ciles i perkasin te dhenat identifikuese si me poshte:

Znj. Nevjana Kacmoli, atesia Hamza, amesia Vjollca, lindur ne Durres me 11/02/1987, dhe banuese ne Durres, Lagja .1, Rruga Anastas Durrsaku, shtetase shqiptare identifikuar me Leternjoftim ID te cilit i pergjigjet numri 033103680 dhe nr. Personal 175211074G.

Kesaj shtetase nen cilesine e administratorit te vetem te shoqerise i caktohet te gjitha fuqite e administrimit me perjashtim te atyre te cilat me ligj dhe statut jane nen kompetencat e asamblese se ortakeve.

NENI 10

Pjese e Kapitalit Themelor, jane lirisht te transferueshme ne rruge trashgimie ligjore ose testamentare, sipas dispozitave te Kodit Civil, dhe ortaket gezojne te drejten e shitjes se kuotave ne mes tyre ose jashte ortakerise, mbi bazen e vendimit te Asamblese Ortakeve dhe sipas procedurave qe jane percaktuar ne Statutin e Shoqerise.

Ortaku ka te drejte te transferoj jashte territorit te Republikespjesisht ose teresisht kontributet e tyre, perfshire dhe fondet dhe vlerat e kontributit ne Natyre ose **nepermjet fitimit te realizuar** bazuar ne te drejten qe u njuh neni 7 Ligjit Nr. 7764 date 02. 11. 1993 " **Per Investimet e Huaja**"

Transferimet e pjeseve te Kapitalit Themeltar, duhet te jene te vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje te tille Ortaket duhet te marrin paraprakisht Vendim me shkrim. Shoqeria dhe te trete, respektojne keto Transferime sapo te behen te ditura.

NENI 11

Me Vendim te Ortakut , ne dispozicion te Shoqerise mund te vihen Fonde te tjera duke perfshire dhe shtesa me ane te Kapitalit ne natyre.

NENI 12

Te ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne Pronesi, Ortakut te vetem te Shoqerise.



NENI 13

Per detyrimet ndaj te treteve qe do te krijohen gjate aktivitetit, shoqeria do te pergjigjet eskuzivisht vetem me kapitalin e saj. Per rrjedhoje, ortaku/ortaket nuk do te kene asnje pergjegjesi per detyrimet e krijuara nga shoqeria, pervecse brenda kufijve te kapitalit te vete shoqerise. Quket e mireqene se me regjistrimin e ketih akti prane Qendres Kombetare te Biznesit – QKB do te konsiderohet i permbushur detyrimi i njoftimit te ortakut te vetem sic parashikohet ne neni 71 te ligjit 9901 date 14/04/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 14

Me Vendim te Asamblese Ortakeve, Shoqeria mund te zgjerohet duke pranuar nje ose me shume ortake te tjere. Shtetas shqiptar apo te huaj, ose te bashkohet me nje Shoqeri tjetere tregtare si brenda vendit dhe jashte shtetit, te zgjeroj Objektin e veprimtarise se saj, te ndahet me mirekuptim mes ortakeve ose ne rruge gjyqesore etj.

NENI 15

Detajimi ne lidhje me problemet dhe administrimin e Kapitalit themeltar dhe te pjeseve nominative te tij, transferimi, zmadhimi ose zvogelimi i Kapitalit mbi bazen e kontributit te Ortakeve te vetem, menyra e Drejtimit Administrativ te Shoqerise, ajo e mbajtjes se llogarive dhe te Bilancit financiar, zgjerimi i Shoqerise ose shndrimi i saj ne nje forme tjetere te Shoqerise Tregtare, bashkimi me Shoqeri te tjera tregtare vendase apo te Huaja, ndarja apo menytrat e falimentimit te saj dhe kalimit ne Likuidim etj, percaktohen ne menyre me te specifikuar ne Statutin e Shoqerise. Per gjithcka qe nuk eshte specifikuar ne kete akt apo statutin e shoqerise do ti referohemi ne menyre te drejtperdrejt ligjeve kompetente ne fuqi.

NENI 16

Kjo Kontrate Themelimi u redaktua ne 4 (kater) ekzemplare ne gjuhen shqipe, me permbajtje e vlera te njejta juridike dhe pasi lexohet, miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i Shoqerise tregtare "**CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS**" **Sh.p.k** i perfaqesuar ne kete akt me prokure nga **Znj. Nevjana Kacmoli** dhe nenshkruhet prej saj ne te gjitha ekzemplet duke vene emrin, mbiemri dhe firma origjinale, autentiviteti i te cilave vertetohet dhe nga Noteri.

ORTAK THEMELUES I SHOQERISE TREGTARE
"CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS" Shpk
DURRES – ALBANIA

Miratues i ketij Akti Themelimi
Shoqeria e Huaj
CRYSTAL SYSTEM GROUP Ltd
Perfaqesuar me prokure nga **NEVJANA KACMOLI**

Nevjana Kacmoli
[Signature]



SHOQËRI TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TE
KUFIZUAR

STATUTI

I SHOQËRISË

“CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS” sh.p.k.

DURRËS – ALBANIA

Durres, me 31. 10. 2019

**SHOQËRI TREGËTARE SIPAS SË DREJTËS SHQIPTARE ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR DHE ORTAK TË VETËM**

**“CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS” SHPK
DURRES - ALBANIA**

STATUTI

**TITULLI I
(EMËRTIMI – OBJEKTI – KOHËZGJATJA – SELIA)**

Neni 1 – Emërtimi

1.1 është themeluar ne Durrës një shoqëri tregtare me një ortak të vetëm me përgjegjësi të kufizuar nën emërtimin " CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS " SH.P.K , një emër që do të shtypet edhe në vulën e kompanisë.

Neni 2 – Selia e shoqërisë dhe vendqëndrimi i ortakëve

2.1 Shoqëria ka selinë zyrtare (ligjore) në Durrës , Lagja 1, RR.Nako Spiro, Durrës 2000, Shqipëri

2.2 Shoqëria , do të kryejë veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe atë ndërkombëtar pa asnjë kufizim. Sipas modaliteteve ligjore dhe vendimmarrjes së Organit të Administrimit, shoqëria mund të krijojë dhe mbyllë(nëse janë krijuar më parë) filiale , degë, agjensi, përfaqësi (zyra përfaqësimi) ,magazina dhe depo , pika kontakti dhe zyra në cdo vend të Shqipërisë dhe jashtë saj.

2.3 Vendqëndrimi i ortakëve , përsa i përket marrëdhënieve me shoqërinë, është ai i përcaktuar në aktin e themelimit, ose më saktë në komunikimin e fundit (shpalljen) të bërë nga shoqëria.

Neni 3 – Objekti i Veprimtarise se shoqërisë

3.1 Shoqëria “CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS” SH.P.K ka si objekt të saj:

- Sherbime konsulence, trajnimi, ndihmese dhe mbeshtetese per implementimin e teknologjive dhe procedurave te metodologjive BIM (BUILDING INFORMATION MODELING) te cilat u drejtohen profesionisteve, ndermarrjeve, shoqerive te inxhinierise dhe zyrave teknike;
- Krijimin, zhvillimin dhe drejtimin e modeleve BIM (BUILDING INFORMATION MODELING);
- Digitalizimin e informacioneve te lidhura me objektet dhe proceset ne faze zhvillimi, projektimi, ndertimi dhe mirembajtje te nje aset;
- Aktivitete ne fushen WEB per shkencat dhe BIM (BUILDING INFORMATION MODELING);
- Koordinimin e njesive kerkimore dhe bashkepunimin ne kerkimet per universitetin, insitutet publike dhe private si dhe ndermarrjet e cdo lloji apo permase;
- Aktivitete dhe sherbime te lidhura me zbulimet shkencore dhe teknologjike;
- Mesimdhënien ne cdo nivel te formimit shkollor dhe universitar;
- Organizim eventesh per perhapjen e njohurive ne fushen dixhitale dhe shkencore;
- Projektimin dhe zhvillimin e projekteve te ndertimit ne pergjithesi si neprmjet BIM dhe CAD dhe gjithashtu te gjitha metodologjite e fushes si per llogari te vet dhe per te trete, si ne ambjetin kombetar dhe nderkombetar;

- 
- Ndertimin per llogari te vet dhe/ose te te treteve, rikostruksionin dhe mirembajtjen e ndertesave te banimit civil, industriale ose te cdo lloji tjeter, te rrugeve, hekurudhave dhe strukturave te lidhura me to;
 - Kryerjen e punimeve publike, punimeve per mbrojtjen apo sistemime hidrike te terrenit, ujesjellesve e kanalizimeve, punime ne fushen detare, apo punime speciale per themele apo konsolidimin e terrenit (tokes);
 - Realizimin e punimeve dhe impianteve ne fushen e mbrojtjes se mjedisit, monumenteve apo ekologjike;
 - Aktivitetin e shit-blerjes-dhenies me qera te pasurive te patundshme ne pergjithesi;
 - Kryerjen dhe ofrimin, ne perputhje dhe respekt te ligjeve ne fuqi, te sherbimeve teknike dhe administrative per llogari te te treteve;
 - Kerkim-studimin dhe eksperimentimin ne sektorin e ndertimit rezidencial;
 - Shoqëria mund të ushtrojë të gjitha aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe financiare, operimin me pasuri të tundshme dhe të patundshme, që nga organet administratuese do të konsiderohen si aktivitete operative, shtesë, të lidhura, të domosdoshme apo të dobishme për realizimin e aktivitetit që përbëjnë objektin social të shoqërisë, të kërkojë interesa apo të ndërmarrë pjesëmarrje në shoqëri apo ndërmarrje të tjera që kanë si objekt aktivitete analoge, të përafërta, të lidhura me të sajat, si në menyrë direkte ashtu edhe indirekte, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë shtetit, e gjithashtu të japë garanci dhe të ofrojë dorëzani në favor të të tretëve, edhe pa pagesë, e gjitha kjo për sa kohë këto aktivitete të mos kryhen në ngarkim të publikut dhe masa e ushtrimit të tyre të mos jetë mbizotëruesë në raport me ato aktivitete që përbëjnë qëllimin social.

Neni 4 – Kohëzgjatja (jetëgjatësia) e shoqërisë

4.1 Jetëgjatësia e shoqërisë është e përcaktuar me KOHË TË PAKUFIZUAR, duke filluar nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe certifikimin e saj si person juridik.

4.2 Kohëzgjatja e kompanisë mund të ndryshohet në cdo kohë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Vendimi duhet të komunikohet dhe të depozitohet menjëherë tek organi kompetent (QKB) në mënyrë që ky i fundit të mund të bëjë ndryshimet e nevojshme në Regjistrin Tregtar.

4.3 Kompania do të kryejë veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi, konventat ndërkombëtare të ratifikuara si dhe në bazë të këtij Statuti dhe të Ligjit 9901, datë 04/14/2018 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

TITULLI II **KAPITALI I SHOQËRISË DHE PJESËMARRJA E ORTAKËVE**

Neni 5 – Kapitali i shoqërisë , kuotat e pjesmarrjes.

5.1 Kapitali i Shoqërisë është **100,000 (njëqind mijë) Lekë** dhe në kohën e themelimit përbëhet nga një kuotë e vetme e caktuar tërësisht për ortakun e vetëm, shoqërinë Crystal System Group Ltd siç parashikohet në aktin e themelimit; ky i fundit mund të rritet ose zvogëlohet me vendim të posaçëm të mbledhjes së ortakëve dhe kontributet mund të bëhen gjithashtu në natyrë ose në kredi.

5.2 Të drejtat mbi shoqërinë u përkasin ortakëve në përputhje me masën proporcionale të pjesëmarrjes që disponon secili ortak.

Neni 6 – Tranferimi i kuotave.

6.1. Siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, kuotat e shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen ose transferohen vetëm përmes:

- a) kontributit direkt në kapitalin aksionar;
- b) shitjes;
- c) kalimit trashëgimor;



ç) dhurimit;

d) në afarëdolloj mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

6.2 Transferimi i kuotave ndërmmjet të gjallëve mund të bëhet vetëm në favor të ortakëve të rinj, për të cilët asambleja me shumicën e kapitalit të shoqërisë, ka dhënë miratimin e saj, duke rezervuar paraprakisht të drejtën e parablerjes në favor të ortakëve të tjerë.

Rrjedhimisht ortaku ofruet (që dëshiron të largohet) duhet të njoftojë anëtarët e tjerë nëpërmjet një letre rekomande në të cilën të përcaktohet çmimi dhe modalitetet e shitjes dhe ortakët e tjerë brenda 30 (tridhjetë) ditëve do të duhet të shprehin vullnetin e tyre për të blerë. Në rast të mungesës së vullnetit për të ushtruar të drejtën e parablerjes, asambleja duhet të miratojë pëlqimin e saj për ortakët e rinj brenda 15 ditëve.

6.3 Në rast vdekjeje të një prej ortakëve, mbledhja e aksionarëve rezervon të drejtën të pranojë trashëgimtarët si ortakë ose të likuideojë pjesëmarrjen e tyre në një vlerë kontabël të barabartë me kapitalin neto që rezulton në kohën e vdekjes.

6.4 Transferimi i aksioneve duhet të bëhet vetëm nëpërmjet një dokumenti me shkrim.

TITULLI III **VENDIMET E ASAMBLESË SË ORTAKËVE**

Neni 7 – Vendimet e ortakëve

7.1 Siç përcaktohet me nenin 82 të Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, anëtarët vendosin nëpërmjet "Asamblesë së Ortakëve" për çështjet e mëposhtme të cilat janë të rezervuara për kompetencat e tyre:

1. përcaktimin e politikave tregtare dhe të drejtimit të shoqërisë;
2. ndryshimet në Statut;
3. vendimet për të kryer operacione që përfshijnë një ndryshim në objektin e shoqërisë ose një ndryshim në të drejtat e ortakëve;
4. vendime në lidhje me shpërndarjen e fitimeve;
5. emërimin dhe shkarkimin e administratorëve si dhe përcaktimin e shpërblimit të tyre;
6. emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
7. miratimin e pasqyrave financiare;
8. vënien në likuidim të shoqërisë dhe emërimin e likuidatorëve;
9. çdo lloj tjetër vendimi për të cilin të paktën një nga administratorët kërkon mbledhjen e asamblesë.

7.2 Asambletë e zakonshme dhe të jashtëzakonshme do të mund të mbahen edhe jashtë selisë ligjore të shoqërisë, qoftë edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Asambletë mund të mbahen edhe në audio – videokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesëmarrjes si më poshtë:

1. duhet të zgjidhet një vend ku të jenë të pranishëm presidenti dhe sekretari i mbledhjes.
2. Duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje;
3. duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuara si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistenca reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

7.3 Në rastin kur asambleja duhet të mbahet në audio – videokonferencë ose në audiokonferencë, në lajmërimin e thirrjes duhet të përcaktohet ora e fillimit të lidhjes telematike dhe vendet e audio – video konferencës të lidhura nën kujdesin e shoqërisë të cilëve do t'i bashkohen pjesëmarrësit: në çdo vend mbledhjeje duhet të mbahet një procesverbal i pjesëmarrjes.

7.4 Asambleja e zakonshme e ortakëve duhet të thirret së paku një herë në vit për miratimin e pasqyrave financiare. Koha e mbledhjes do të përcaktohet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.



Neni 8 – Efikasiteti i vendimarrjes së Asamblesë

8.1 Asambletë e formuara dhe të thirrura rregullisht përfaqësojnë të drejtën universale të ortakëve dhe vendimet e marra në përputhje me ligjin dhe me aktin në fjalë i detyron të gjithë ortakët edhe ata të munguar ose kundërshtues me përjashtim të atyre që kanë përdorur të drejtën e tërheqjes sic parashikohet në ligj.

Neni 9 – Thirrja dhe vendi i Asamblesë

9.1 Asambleja e ortakëve e cila mund të mbahet si në selinë e shoqërisë ashtu edhe në vend tjetër do të thirret nga organi administrativ përmes një lajmërimi të dërguar ortakëve, këshilltarëve dhe anëtarëve të organit të kontrollit, nëse ata janë emëruar të paktën shtatë ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen në adresën të cilën cdo i interesuar i ka komunikuar paraprakisht shoqërisë.

9.2 Lajmërimi i thirrjes duhet të përmbajë përshkrimin e ditës, orës dhe vendit ku do të mbahet mbledhja si edhe çështjet mbi të cilat asamblesë i kërkohet të marrë vendime.

9.3 Në të njëjtin lajmërim mund të fiksohet për një ditë tjetër një mbledhje e dytë në rast se e para nuk do kishte pjesëmarrje apo nuk do të mund të formohej rregullisht.

9.4 Lajmërimi mund të redaktohet në cdo lloj forme qoftë në letër apo elektronik dhe mund të dërgohet me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë sigurohet se mund të provohet marrja e këtij njoftimi.

9.5 Sipas nenit 83 paragrafi 2 të Ligjit 9901 të datës 14 prill 2008, do të konsiderohen gjithsesi të vlefshme vendimet e Asamblesë që nuk janë ngitur në formë të rregullt nëse të gjithë ortakët kanë marrë pjesë dhe kanë shprehur pëlqimin e tyre për të vendosur.

Neni 10 – Ndërhyrja dhe përfaqësimi në Asamble

10.1 Mund të ndërhyjnë në asamble të gjithë ata që rezultojnë të jenë ortakë në datën e asamblesë.

10.2 Cdo ortak mund të përfaqësohet përmes një autorizimi të shkruar lëshuar ndaj kujtdo personi tjetër i cili mund të mos jetë domosdoshmërisht ortak, me përjashtimin e qartë të administratorëve të shoqërisë, të cilët sipas dispozitave që parashikon ligji kanë ndalimin absolut për të vepruar si përfaqësues të kujtdo ortaku.

10.3 Prokura/autorizimi mund të lëshohet vetëm për një mbledhje të vecantë, pa përjashtuar gjithashtu mbledhjet vijuese në vazhdimësi që kanë të bëjnë me të njëjtin "rend dite".

Neni 11 – Presidenti i Asamblesë

11.1 President i asamblesë është ose administratori i vetëm ose presidenti i këshillit të administrimit, në rastin e emërimit nga një organ kolegjal ose në mungesë të tyre nga një person i përzgjedhur nga asambleja, që emëron një sekretar I cili mund të mos jetë ortak.

11.2 Vendimet e asamblesë duhet të paraqiten në një procesverbal të posaçëm të firmosur nga presidenti dhe sekretari I mbledhjes; dhe në rastet e parashikuara me ligj, procesverbali duhet të redaktohet nga noteri.

11.3. Procesverbali duhet të ketë datën dhe vendin e mbledhjes, emrin e Presidentit dhe Sekretarit dhe rezultatin e vendimarrjes. Për më tepër, këtij të fundit duhet ti bashkëngjitet listëprezenca e pjesëmarrësve dhe akti i thirrjes së Asamblesë.

Neni 12 – Kuorumet e asamblesë

12.1 Siç përcaktohet me nenin 86 të Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, Asambleja konsiderohet të jetë e rregullt, kur në të marrin pjesë ortakët që përfaqësojnë më shumë se 30% të kapitalit të shoqërisë.

12.2 Për vendimet e parashikuara në nenin 87 të Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, Asambleja do të konsiderohet rregullisht e ngritur nëse janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë më shumë se 50% të kapitalit të shoqërisë. Në thirrjen e parë, takimi është rregullisht i ngritur me praninë e ortakëve që përfaqësojnë të paktën gjysmën e kapitalit të shoqërisë dhe vendosin me shumicë absolute.

12.3 Në mungesë të kuorumeve të parashikuara në këtë nen, asambleja duhet të thirret jo më vonë

se 30 ditë nga thirrja e parë. Në thirrjen e dytë, asambleja është mbledhur në mënyrë të vlefshme pa marrë parasysh pjesën e kapitalit shoqëror të përfaqësuar dhe zgjedh me votën e favorshme të shumicës së të pranishmëve.

12.4 Me urdhër të ditës të përcaktuar me nenin 81 të Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, asambleja vendos me votën e favorshme të shumicës së pjesëmarrësve. Për më tepër, mbi modifikimet e aktit të themelimit dhe mbi emërimin dhe fuqitë e likujduesve, asambleja mund të mbahet rregullisht dhe vendimet e saj të jenë të vlefshme qoftë në thirrjen e parë ashtu edhe në të dytën vetëm me prezencën e 75% të ortakëve dhe me votën pro të aq ortakëve sa të arrihet shumica e kapitalit të shoqërisë.

TITULLI IV **ADMINISTRIMI DHE PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË**

Neni 13 – Administrimi i Shoqërisë

13.1. Kompania menaxhohet, në varësi të rezolutës të miratuar herë pas here nga mbledhja e aksionarëve, nga një drejtor i vetëm, ose nga një bord i drejtorëve i përbërë nga dy deri në pesë anëtarë, të emëruar edhe nga jo-anëtarë. Në pajtim me nenin 95 paragrafi 5 të Ligjit 9901 të datës 14.04.2008, në rast se shoqëria administrohet nga më shumë se një drejtor, si në rastin e Bordit të Drejtorëve ose të administratës, administratorët mund të zgjedhin të sigurojnë disjunktiv. Në kohën e inkorporimit, kompania menaxhohet nga një Administrator i vetëm, dhe Administratore e Vetme e shoqërisë është zonja Nevjana Kacmoli.

13.2 Kohëzgjatja në detyrë e administratorëve është 5 vjetecare e rinovueshme.

13.3 Shpërblimi dhe pjesmarrja në fitime e administratorit të vetëm dhe anëtarëve të këshillit administrativ përcaktohen nga ortakër.

13.4 Administratorit të vetëm ose anëtarëve të këshillit administrativ, u takon gjithashtu edhe rimbursimi i shpenzimeve të kryera për arsye të detyrës së tyre.

13.5 Siç është parashikuar nga Neni 207 i Ligjit 9901 të datës 14/04/2008, drejtorët e shoqërisë mëmë nuk mund të emërohen drejtorë të një filiali / dege dhe anasjelltas. Çdo caktim në kundërshtim me këto dispozita do të konsiderohet si i pavlefshëm.

Neni 14 – Presidenti, zëvendës-presidenti dhe administratori i deleguar

14.1 Bordi i Drejtorëve mund të zgjedhë nga radhët e anëtarëve një president dhe një zëvendës-president i cili zëvendëson presidentin në rast mungese ose pengese, një ose më shumë administrator të deleguar dhe madje edhe jashtë anëtarëve të tij, një sekretar.

Neni 15 – Vendimet e Këshillit administrativ

15.1 Vendimet e këshillit administrativ merren me mledhje kolegiale.

15.2 Vota nuk mund të jepet përmes përfaqësimit.

Neni 16 – Mbledhja kolegiale e Këshillit Administrativ.

16.1 Këshilli administrativ do të mblidhet në selinë e shoqërisë ose në cdo vend tjetër në Shqipëri ose jashtë, cdo herë që presidenti do ta quajë të nevojshme dhe kur do të kërkohet me shkrim nga të paktën dy prej anëtarëve të tij ose nga organi i kontrollit nëse kemi një të tillë të emëruar.

16.2 Si rregull thirrja do të bëhet përmes lajmërimit me anë të cdo lloj sistemi komunikimi për sa kohë që mund të provohet marrja e kësaj thirrje përmes atij sistemi, këshilltarëve të paktën shtatë ditë para datës së përcaktuar për mbledhjen me përjashtim rasteve urgjente kur lajmërimi duhet të dërgohet të paktën tre ditë para mbledhjes.

Në të njëjtat terma lajmërohen edhe anëtarët e organit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar.

16.3. Që rezolutat e këshillit të jenë të vlefshme, shumica e anëtarëve në detyrë duhet të jenë të pranishëm.



16.3 Këshilli administrativ mund të mbahet rregullisht dhe të quhet akt vendimmarrës edhe në mungesë të formaliteteve të sipërpërmendura , nëse në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij dhe anëtarët e oranit të kontrollit nëse ka një të tillë të emëruar , pa anashkaluar të drejtën e secilit pjesmarrës për të kundërshtuar diskutimin e argumenteve mbi të cilat konsideron se nuk është informuar mjaftueshëm.

16.4 Mbledhja mund të mbahet edhe në audio – videokonferencë ose edhe vetëm në audiokonferencë për sa kohë janë siguruar të drejtat e pjesmarrjes si më poshtë:duhet të zgjidhe një vend ku të jenë të pranishëm të paktën presidenti dhe sekretari i mbledhjes, duhet të bëhet i mundur identifikimi i saktë i personave të legjitimuar për të marrë pjesë në mbledhje, duhet të sigurohet mundësia e gjithsecilit për të ndërhyrë verbalisht mbi të gjitha argumentet e trajtuara si edhe për të vrojtuar apo marrë dhe përcjellë informacion në kohë reale. Egzistenca reale e të drejtave në fjalë duhet të konstatohet nga presidenti i mbledhjes i cili duhet t'i regjistrojë në procesverbalin e mbledhjes.

16.5 Mënyra e deklarimit të votës nuk duhet të anashkalojë faktin se në cdo rast duhet të jenë mënyra që lejojnë evidentimin e atyre që japin vota kundër ose abstenojnë , vendosen me shumicën absolute të votave të të pranishëmve.

Neni 17 – Vendime të marra me mbledhje kolegjale

17.1 Këshilli administrativ merr vendime të vlefshme me shumicë absolute të votave të anëtarëve të saj; në rast barazie të votave mbizotëron vota e presidentit për sa kohë këshilli të përbëhet prej më shumë se dy anëtarëve.

17.2 Vendimet e këshillit duhet të konstatohen nga verbal i transkriptuar në një libër të posacëm të mbajtur sipas normave ligjore dhe nënshkruar nga presidenti dhe sekretari i mbledhjes.

Neni 18 – Kompetencat e organit administrativ

18.1 Organi administrativ është i veshur me fuqitë më të gjera të zakonshme dhe të jashtëzakonshme të administrimit, me përjashtim të atyre që ky akt i rezervon si kompetenca ekskluzive të vendimeve të ortakëve me përjashtim të blerjes dhe shitjes së pasurive të patundshme dhe kërkesës për kredi, hua ose llogari bankare. Për këto të fundit, do të jetë e detyrueshme shqyrtimi i mëparshëm i Asamblesë së Zakonshme që do të duhet të japë pëlqimin e vet për këto operacione me votim të favorshëm të bashkëpunëtorëve që përfaqësojnë 75% të kapitalit shoqëror.

18.2 Këshilli i administrimit ose administratori i vetëm do të ketë pra, ndër të tjera, të drejtën për të blerë, shkëmbyer, shitur pasuri të tundshme, automjete , ti përfshijë në shoqëri , të marrë aksione dhe interesa , të marrë dhe obligacione, të emerojë prokurues për akte ose kategori aktesh , drejtorë e cdo gjë tjetër që do të konsiderohet e domosdoshme për qëllimet e shoqërisë.

18.3 Në rastin kur shoqëria administrohet nga një këshill, këshilli mund të delegojë pjesërisht ose tërësisht atributet dhe fuqitë e tij tek Presidenti, Zv.Presidenti. apo tek një apo më shumë administratorë të deleguar duke përcaktuar paraprakisht modalitetet dhe kufijtë e ushtrimit të fuqive të deleguara.

Neni 19 – E Drejta e Firmes dhe Përfaqësimi i Shoqërisë

19.1 Përvec rasteve të parashikuar në nenin e mëparshëm 18.3 , firma dhe përfaqësimi i shoqërisë i takojnë administratorit të vetëm ose presidentit të këshillit administrativ dhe/ose Administratorit te Deleguar.

19.2 Përfaqësuesit ligjorë të kompanisë mund të emërojnë përfaqësues me prokurë duke u dhënë atyre pjesë të kompetencave të tyre. Ky emërim duhet të bëhet vetëm përmes një akti noterial.



TITULLI V ORGANI I KONTROLLIT

Neni 20 – Organi i kontrollit.

20.1. Nëse përmbushen predispozitat ligjore ose vendoset nga Asambleja, shoqëria emëron një organ mbikëqyrës, i cili mund të përbëhet nga një audit i vetëm ligjor ose një studio profesionale auditimi.

TITULLI VI BILANCI – FITIMET

Neni 21 – Periudha fiskale ushtrimore, bilanci dhe fitimet.

21.1 Periudha fiskale ushtrimore mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor të cdo viti. Periudha e parë ushtrimore mbyllet më 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2019 (dymijë e nëntëmbëdhjetë) .

21.2 Bilanci i cili duhet hartuar në përputhje me dispozitat e patjetërsuara ligjore, duhet tu paraqitet ortakëve për miratim brenda afatit të 31 Marsit të cdo viti, përvec mundësive kur mund të ketë një afat më të gjatë brenda kufijve dhe kushteve të përcaktuara me ligj.

21.3 Fitimet neto të rezultuara nga bilanci do të ndahen kështu :

- 5 % (pesë për qind) në ngritjen e një fond rezerve ligjore , deri në arritjen e një shume të barabartë më një të katërtën e kapitalit të regjistruar;
- fitimi i mbetur do të shpërndahet ose do të lihet mënjanë në varësi të vendimeve të ortakëve që aprovojnë bilancin.

Në cdo rast , nesë verifikohet humbje kapitali , nuk mund të ketë shpërndarje fitimesh deri kur kapitali i shoqërisë të riintegrohet dhe të kthehet në masën e duhur.

TITULLI VII SHKRIRJA, PËRJASHTIMI I ORTAKËVE, LIKUJDIMI DHE MOSMARRVESHJET

Neni 22 – Shkrirja e Shoqërisë

22.1 Shoqëria konsiderohet e shkrirë vetëm në rastet e parashikuara nga ligji.

22.2 Në cdo rast shkrirje të shoqërisë , ortakët do të përcaktojnë një ose më shumë likuidatorë, duke përcaktuar gjithashtu fuqitë dhe shpërblimin e tyre.

Neni 23 – Dispozita të përgjithshme

23.1 Për gjithcka që nuk është shprehimisht e parashikuar në aktin e themelimit ose në këtë statut , do t'i referohet shprehimisht dispozitave ligjore ne fuqi në momentin konkret.

ORTAK THEMELUES I SHOQËRISE TREGTARE
“CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS” Shpk
DURRES – ALBANIA

Miratues i ketij Statuti
Shoqëria e Huaj
CRYSTAL SYSTEM GROUP Ltd
Perfaqësuar me prokure nga NEVJANA KACMOLI

Nejvana Kacmoli

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE
DEGA VENDORE DURRES

Rep nr. 5156
Kol nr. 421/1



NOTERE
ENTELA P. FILO

Rr. "Aleksander Goga" Nr. 641, Durres, Albania, Cel: +355692063870, e-mail: entelafilo@yahoo.com

VERTETIM NENSHKRIMI

Vertetoj, ne cilesine e njohur nga **Ligji nr.110**, date 20. 12. 2018 "Per Noterine" Neni 128, sipas te cilit:

"Vertetimi i nenshkrimeve:

Vërtetimi i nënshkrimeve bëhet për akte private që nuk përmbajnë lidhjen e një kontrate ose kryerjen e një veprimi tjetër juridik. Vërtetimi bëhet në fund të aktit, pas nënshkrimeve, duke u bërë shënimi nga noteri se personat u paraqitën personalisht dhe nënshkruan në prani të tij ose pranuan se nënshkrimet janë të tyre."

Si dhe Udhezimit nr. **6291**, date 22. 08. 2005, te Ministrit te Drejtesise, pika 3 dhe 4, se u paraqit personalisht para meje Notere **ENTELA P. FILO**, me Studio Noteriale te ndodhur ne Durres, Rr. Aleksander Goga 641, anetare e Deges Vendore Durres, shtetasja e poshte – shenuar, madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, e cila nenshkruan ne pranine time dokumentin bashkelidhur ketij akti «**Akt – Themelimi dhe Statuti**» i Shoqerise «**CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS**» sh.p.k. i redaktuar prej vete saj jashte kesaj Studio Noteriale, pasi me deklarom se aprovon dhe pranom plotesisht permbajtjen e aktit, si vijon:

- **NEVJANA KACMOLI**, atesia HAMZA, lindur me 11. 02. 1987, ne DURRES, banuese ne Durres, Lagja 1, Rr. Anastas Durrsaku, per identitetin e te ciles u sigurova me ane te Kartes se Identitetit me numer personal I75211074G, aktualisht perfaqesuese me prokure e ortakut themelues dhe administratore e shoqerise «**CRYSTAL BUILDING SOLUTIONS**» sh.p.k me kapital themeltar 100.000 LEK.

Akti i vertetimit te nenshkrimit u redaktua ne 4 (kater) ekzemplare.

Durres, me 31. 10. 2019, dite e ENJTE, ora 10:30.

NOTERE
ENTELA P. FILO

ENTELA P. FILO
Notere
Cel: 069 20 63 870

